



Edukimi për të vërtetën

Gjendja e edukimit medial dhe sfidat e
përfshirjes në kurrikula mësimore

HIBRIDO.INFO

Edukimi për të vërtetën

Gjendja e edukimit medial dhe sfidat e përfshirjes në kurrikula mësimore

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, korrik 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian (BE). Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e ADS/Hibrid.info dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti mbështetet nga:



Funded by
the European Union

Projekti realizohet nga:



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
METODOLOGJIA.....	7
1. KONCEPTI I EDUKIMIT MEDIAL.....	8
1.1. ORGANIZATA PËR EDUKIM, SHKENCË DHE KULTURË E KOMBEVE TË BASHKUARA (UNESCO).....	9
1.2. BASHKIMI EVROPIAN (BE).....	11
1.3. KËSHILLI I EVROPËS (KIE).....	13
2. ANALIZË E KONTEKSTIT TË EDUKIMIT MEDIAL NË KOSOVË.....	14
2.1. EDUKIMI MEDIAL NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË..	17
2.1.1. KURRIKULA DHE PLAN-PROGRAMET MËSIMORE NË KOSOVË....	19
2.1.2. TRAJNIMET E MËSIMDHËNËSVE PËR EDUKIM MEDIAL.....	24
REKOMANDIME.....	28

HYRJE

Ky raport ka për qëllim të analizojë gjendjen aktuale sa i përket edukimit medial në Kosovë, veçanërisht në kuadër të arsimit parauniversitar, në shkollat fillore dhe të mesme. Gjetjet nga raporti tregojnë se deri më tash kanë munguar nisma konkrete nga niveli institucional për ta trajtuar edukimin medial si nevojë urgjente dhe me prioritet në sistemin arsimor. Me kurrikulën dhe plan-programet aktuale mësimore, edukimi medial trajtohet vetëm si një çështje ndërkurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Edhe pse me kurrikulën aktuale mësimore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) është e obligueshme që edukimi medial të përfshihet në të gjitha lëndët e rregullta mësimore si temë ndër-kurrikulare në arsimin parauniversitar, ende nuk dihet se cili është niveli i përfshirjes së saj nga ana e mësimdhënësve nëpër lëndët e ndryshme mësimore. Niveli politik i kësaj ministrie ka konstatuar se në lëndët “Gjuhë dhe letërsi” dhe “Edukata qytetare” kanë tema që ndërlidhen me edukimin medial. Për më tepër, MASHTI që merret me politikat arsimore në vend, nuk pritet të bëjë ndryshime në kurrikulën mësimore për ta përfshirë edukimin medial si lëndë të obligueshme mësimore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë, duke preferuar që ajo të trajtohet e integruar vetëm në mënyrë ndër-sektoriale përmes lëndëve të ndryshme mësimore.

Pavarësisht kësaj, viteve të fundit vërehen disa lëvizje pozitive nga ana e institucioneve shkollare dhe mësimdhënësve në arsimin parauniversitar për ta përfshirë edukimin medial si mësim/lëndë me zgjedhje (lëndë zgjedhore) nëpër shkolla. Në disa prej shkollave, edukimi medial është i përfshirë tashmë si lëndë me zgjedhje, e cila lejohet me kurrikulën aktuale mësimore. Megjithatë, në mungesë të teksteve mësimore të standardizuara për edukimin medial për shkollat fillore e të mesme, mësimdhënësve u duhet të përgatitin materialet mësimore për nxënësit që zgjedhin edukimin medial si lëndë me zgjedhje, e cila ka koston e vet financiare dhe profesionale. Në këtë drejtim, nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e shkollave e mësimdhënësve që kanë si lëndë zgjedhore edukimin medial dhe as numri i nxënësve që kanë treguar interesim të marrin edukimin medial si mësim me zgjedhje.

Disa prej sfidave kryesore të këtij procesi që ndërlidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin medial janë listuar si në vijim:

- Mësimdhënia në arsimin parauniversitar vazhdon të kultivohet në formë tradicionale dhe mekanike, pavarësisht se kurrikula e re mësimore mëton të nxis zhvillimin e shkathtësive dhe mendimin kritik të nxënësve. Ndërkaq, vërehet se shkollat në Kosovës kanë mbetur shumë mbrapa sa i përket digjitalizimit dhe trendëve të reja bashkëkohore të arsimit. Po ashtu, edhe njohuritë e mësimdhënësve për edukimin medial vlerësohen të mangëta nga njohësit e edukimit medial.
- Zbatimi i kurrikulës nga mësimdhënësit paraqet një problematikë tjetër për të cilën mungojnë informata dhe të dhëna empirike. Gjithashtu, mungojnë informata lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës në arsimin parauniversitar, veçanërisht për nivelin e përfshirjes së edukimit medial si temë ndërkurrikulare në shkollat fillore dhe të mesme.
- Trajnimi i mësimdhënësve për edukimin medial kryesisht bëhet nga organizata joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat janë të varura financiarisht nga donatorët e huaj. Sipas të dhënave, mbi 3,500 mësimdhënës janë trajnuar viteve të fundit për edukimin medial nga organizata joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë. Megjithatë, kjo ndikon që këto trajnime të mos jenë të qëndrueshme dhe të rregullta. Për më tepër, Ministria e Arsimit vazhdon t'i trajtojë programet trajnuese të edukimit medial si "programe plotësuese" ose sekondare duke mos e trajtuar me prioritet zhvillimin profesional të mësimdhënësve për edukimin medial. Ndërkaq, sfida në vete është edhe ndikimi i këtyre trajnimeve tek mësimdhënësit për të vetëdijësuar nxënësit lidhur me rëndësinë e edukimit medial dhe sa arrijnë mësimdhënësit të transmetojnë tek nxënësit njohuritë e fituara profesionale nga programet e trajnimit.
- Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë japin në vazhdimësi kontribut të theksuar në trajnimin e të rinjve, përfshirë nxënësit e shkollave të mesme dhe studentëve kosovarë, për rëndësinë e edukimit medial. Sfida kryesore në këtë drejtim është qëndrueshmëria e trajnimeve meqë varen financiarisht nga komuniteti i donatorëve të huaj. Megjithatë, shoqëria civile në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në vazhdimësi avokojnë për ta integruar edukimin në procesin e rregullt mësimor.

- Edhe pse mungojnë informata zyrtare për zbatimin e kurrikulës mësimore në shkollat fillore dhe të mesme, të dhënat e testit PISA për vitin 2022 e vendosin Kosovën në fund të listës sa i përket mendimit kritik të nxënësve kosovarë. Njohuritë e këtyre të fundit për lexim, matematikë dhe shkencë janë jashtëzakonisht të dobëta, me theks të veçantë në zgjidhjen e problemeve komplekse, për të menduar në mënyrë kritike dhe komunikuar në mënyrë efektive. Kjo mbase tregon edhe për nivelin e cilësisë së arsimit parauniversitar në përgjithësi dhe të mësimdhënies në veçanti, në Kosovë. Megjithatë, sipas raportit të PISA-s për Kosovën më 2022, nxënësit tanë pothuajse nuk mund të kuptojnë tekste të gjata dhe të bëjnë dallimin ndërmjet faktit dhe opinionit që ndërlidhet me edukimin medial.
- Kosova është renditur pothuajse në fund të listës edhe në Indeksin Evropian për Edukimin Medial më 2023 nga Instituti për Shoqëri të Hapur në Sofje. Matjet e bëra nga ky indeks më 2023 tregojnë se prej 41 vendeve evropiane, në të cilat janë bërë matjet për edukimin medial, Kosova është renditur e parafundit në vendin e 40 me vetëm 21 pikë një vend më lartë se Gjeorgjia e renditur në vendin e fundit (41) me 20 pikë. Përmes këtij indeksi matet edukimi medial përmes indikatorëve të caktuar, siç janë niveli i edukimit, gjendja e mediave, besimi në shoqëri dhe përdorimi i mjeteve të reja për pjesëmarrje.
- Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 98.06 për qind e ekonomive familjare në Kosovë kanë qasje në internet dhe grupmoshat e reja prej 16-24 vjeç përdorin më së shumti internetin. Kjo grupmoshë i përket edhe nxënësve të shkollave të mesme që është një tregues i depërtimit masiv të internetit tek nxënësit, e cila bartë rreziqe në vete duke iu ekspozuar drejtpërdrejt përmbajtjeve të ndryshme në internet në mënyrë të pakufizuar, qoftë në mediat online, mediat sociale dhe faqet tjera në internet.

Përmes këtij raporti synohet pasqyrimi i gjendjes së edukimit medial në arsimin parauniversitar dhe ofrohen disa rekomandime si hapa të nevojshëm për të bërë përmirësime në mënyrë të posaçme tek procesi i mësimdhënies sa i përket edukimit medial në shkollat e Kosovës. Rekomandimet kanë për qëllim të ndihmojnë të gjitha palët (Ministrinë e Arsimit, komunat, shkollat, organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, komunitetin e donatorëve etj.) për të intervenuar me urgjencë lidhur me trajtimin me prioritet të temës së edukimit medial në sistemin arsimor.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti janë shfrytëzuar metodat kualitative për të pasqyruar situatën e edukimit medial në Kosovë. Në funksion të analizës të të dyja seksioneve të raportit, janë shqyrtuar materiale të ndryshme të publikuara dhe që janë të qasshme në internet, si dhe janë realizuar intervista me akterë të ndryshëm në Kosovë, siç shpjegohet në vijim:

- Për seksionin e parë të raportit është bërë rishikimi i literaturës së organizatave ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e edukimit medial. Arkivat e publikimeve të UNESCO-s janë shqyrtuar për të definuar konceptin e edukimit mbi median dhe informacionin në përgjithësi. Po ashtu, edhe materialet e publikuara nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës kanë ndihmuar në konceptimin e kësaj teme për ta bërë më të lehtë për audiencat e gjera domethënien e konceptit të edukimit medial dhe informacionit.
- Sa i përket seksionit të dytë të raportit që i kushtohet tërësisht edukimit medial në Kosovë janë bërë dhjetë (10) intervista gjithsej. Intervistat përfshijnë zyrtarë të lartë të MASHTI-t, mësimdhënës të shkollave publike dhe private që ligjërojnë edukimin medial në shkollat fillore dhe të mesme, aktivistë të shoqërisë civile, njohës të çështjeve të arsimit parauniversitar dhe edukimit medial, gazetarë dhe zyrtarë të organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Pos kësaj, janë shqyrtuar edhe materiale të tjera të publikuara në mediat e Kosovës dhe publikime e strategji të Ministrisë së Arsimit.

Hartimi i këtij raporti ka qenë i kufizuar nga mungesa e dukshme e burimeve që trajtojnë temën e edukimit medial në arsimin parauniversitar. Prandaj, duke qenë ndër nismat e pakta për përfshirjen e edukimit medial në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë, ky raport synon të hedhë dritë në disa prej çështjeve më kryesore dhe urgjente mbi edukimin medial në Kosovë që prekin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në rend të parë, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore përgjithësisht.

1. KONCEPTI I EDUKIMIT MEDIAL

Ndikimi dhe dominimi masiv i mediave tradicionale dhe atyre online, mediave sociale dhe mjeteve të teknologjisë informative përmes ndërveprimit në internet (kompjuteri, telefonat mobilë dhe pajisjet tjera të avancuara digjitale), gjatë dekadave të fundit ka ngritur nevojën urgjente për edukim të gjeneratave se si informohen nga lajmet e publikuara në media, si i përdorin pajisjet teknologjike dhe sa të dobishme, apo të dëmshme mund të jenë ato (qoftë lajmet apo pajisjet teknologjike) për njerëzit në përgjithësi.

Edukimi medial ndihmon individët të zhvillojnë një kritikë të shëndetshme ndaj informacionit mediatik. Kjo përfshin aftësinë për të vlerësuar burimet, përmbajtjen dhe qëllimet e informacionit që i japin, si dhe për të kuptuar sesi ndikon media në perceptimet dhe opinionet e tyre. Në një kohë kur media është e mbushur me shumë informacion dhe ndikime të ndryshme, edukimi medial mund të ndihmojë njerëzit të zhvillojnë aftësinë për të formuar mendime dhe opinione të pavarura, duke analizuar dhe vlerësuar informacionin në mënyrë objektive.

Media është në një ndryshim të vazhdueshëm, duke përfshirë zhvillimin e teknologjisë dhe platformave të reja. Edukimi për media mund të ndihmojë njerëzit të përshtaten me këto ndryshime dhe a përdorin teknologjinë dhe mediat në mënyrë të zgjuar dhe të përgjegjshme. Ndryshimi i shpejtë i teknologjisë dhe shpërndarja e gjerë e platformave sociale ka bërë që dezinformimi të jetë një problem i madh. Edukimi medial mund të ndihmojë njerëzit ta identifikojnë dhe ta shmangin dezinformimin, duke iu dhënë atyre mjete për ta verifikuar dhe vlerësuar informacionin që marrin.

Për këtë qëllim, institucione dhe organizata ndërkombëtare janë angazhuar në definimin e edukimit medial në një botë gjithnjë e më të ndërvarur nga informacioni i shpejtë dhe teknologjia digjitale.

1.1. ORGANIZATA PËR EDUKIM, SHKENCË DHE KULTURË E KOMBEVE TË BASHKUARA (UNESCO)

Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), mbase ka kontribuar më së shumti në konceptimin e edukimit medial nga këndvështrimi edukues dhe shkencor. Kuptimi më i thjeshtë i 'edukimit medial', sipas UNESCO-s, është aftësia për të kuptuar funksionet e mediave, për të vlerësuar se si zbatohen ato funksione në praktikë dhe angazhimi në mënyrë racionale me median për t'u shprehur.[1] Megjithatë, në funksion të një kuptimi më gjithëpërfshirës të kësaj teme komplekse, UNESCO ka kombinuar nocionin e edukimit medial me atë të 'edukimit mbi informacionin' i cili nënkupton rëndësinë për t'i qasur informacioneve, si dhe vlerësimin dhe shfrytëzimin në mënyrë etike të informacioneve të tilla.[2] Ndonëse këto dy koncepte dallojnë nga njëra tjetra (edukimi medial nga edukimi mbi informacionin), UNESCO i ka përbashkuar (unifikuar) këto dy koncepte në nocionin "Edukimi mbi Median dhe Informacionin"[3] për të përfshirë në një fjali njëkohësisht rëndësinë e mediave dhe informacionit.

Në Kosovë, ky nocion mund të jetë relativisht i ri dhe i panjohur për shkak të mungesës së literaturës adekuate në gjuhën shqipe, mospërdorimit të këtij nocioni nga profesionistë të fushës (akademikët, hulumtuesit, ekspertët, gazetarët etj.) dhe si pasojë e trajtimit sipërfaqësor të edukimit mbi median dhe informacionin nga palë të ndryshme. Në anën tjetër, në gjuhën angleze ("Media and Information Literacy" e njohur me shkurtesën MIL) ka tashmë përdorim të gjerë edukimi mbi median dhe informacionin me të cilën synohet të edukohen shoqëritë mbi rolin dhe peshën e mediave dhe informacionit në përgjithësi përmes edukimit formal dhe atij joformal.

Me qëllim të qartësimit të këtyre dy koncepteve që përbëjnë edukimin mbi median dhe informacionin, UNESCO në vitin 2013 ka publikuar kurrikulën mësimore për mësimdhënësit mbi këtë temë,[4] në të cilën bëhet i qartë dallimi mes edukimit mbi informacionin dhe edukimit medial, siç vërehet në tabelën e mëposhtme:

[1] Grizzle, A., & Wilson, C. (Eds.). (2011). Media and Information Literacy: Curriculum for Teachers, f. 18. Paris: UNESCO.

[2] Po aty.

[3] Po aty.


[4] Po aty, fq. 18-19.

Tabela 1: Elementet e edukimit mbi median dhe informacionin (UNESCO, 2013)

Edukimi mbi informacionin:



Edukimi medial:



Gjatë shqyrtimit të literaturës vërehet se ekziston një debat i gjerë për lidhjen ndërmjet edukimit medial dhe edukimit për informim. Në parim ekzistojnë dy mendime të kundërta me njëra-tjetrën sa i përket këtyre dy koncepteve: i) njëri se edukimi për informim është fushë më e gjerë studimi, në të cilin edukimi medial është një nënfushë në kuadër të saj dhe ii) tjetri se edukimi për informim është thjesht pjesë e edukimit medial si fushë më e gjerë. Megjithatë, UNESCO përmes grupit të ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar për këto çështje ka konstatuar se pavarësisht dallimeve dhe ngjashmërive ndërmjet këtyre dy koncepteve, ekzistojnë lidhje të ngushta jo vetëm ndërmjet edukimit medial dhe edukimit për informim, por edhe me fusha të tjera, si liria e shprehjes dhe edukimi për informim, edukimi për lajme, edukimi për kompjuter, edukimi për internet, edukimi digjital etj.[5]

Edhe organizatat evropiane, siç janë Bashkimi Evropian (BE), Këshilli i Evropës (KiE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), i kanë kushtuar vëmendje çështjeve të edukimit medial dhe informimit, të cilat shqyrtohen në nën-seksionet vijuese të raportit.

1.2. Bashkimi Evropian (BE)

BE-ja gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa veprime në këtë fushë duke konstatuar se “edukimi medial nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm sesa që është sot”. [6]

Në vitin 2023, Komisioni Evropian ka publikuar udhëzuesin për edukim medial që do t’ju ndihmojë shteteve anëtare të BE-së të raportojnë për aktivitetet përkatëse në edukimin medial dhe ka për qëllim t’u ndihmojë atyre t’i ndajnë praktikat më të mira në lidhje me edukimin medial.[7] Ky udhëzues i referohet Veglave të Edukimit Medial të vitit 2021, i përgatitur nga Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Mediale Audiovizuale dhe Komisioni Evropian me synim zbatimin efikas dhe praktik të obligimeve për edukimin medial nga ana e platformave të cilat shpërndajnë video në funksion të ngritjes së vetëdijesimit të përdoruesve të mediave sociale, si dhe të rrisë shkathtësitë e tyre kritike.[8] Kjo nënkupton se

[5] Po aty, f. 19.

[6] European Commission. (21 shkurt 2023). [Commission publishes its media literacy guidelines.](#)

[7] Po aty.

[8] European Regulators Group for Audiovisual Media Services. [Action Group on Media Literacy - ERGA Media Literacy Report: Recommendations for key principles, best practices and a Media Literacy Toolbox for Video-sharing Platforms.](#)

BE-ja ka ndërtuar mekanizma të mbështetur në legjislacion përmes të cilave përcakton se platformat që shpërndajnë përmbajtje përmes videove të ndërtojnë mjete efikase për edukimin medial dhe ta ngritin vetëdijen e përdoruesve që shfletojnë materiale të tilla.

Marrë parasysh se edukimi medial është i ndërlidhur ngushtë me edukimin digjital, zyrtarë të lartë të BE-së të angazhuar në çështjet e teknologjisë dhe të digjitalizimit kanë alarmuar se “gjenerata jonë dhe përdoruesit më të rinj të internetit” nuk kanë marrë njohuritë e duhura për edukimin digjital. Madje, sipas tyre, “ka mungesë të theksuar të shkathtësive digjitale në Evropë dhe atë në shumë fusha të sferës digjitale: që nga përdorimi i platformave të mediave sociale deri tek një kërkim i thjeshtë në internet”.[9] Kjo ka qenë mbase arsyeja mbizotëruese për hartimin e udhëzuesit të edukimit medial në nivel të BE-së për t’u ndihmuar vendeve anëtare në atë drejtim sepse edukimi medial, jo vetëm që ndikon në edukimin e gjeneratave të reja, por edhe kontribuon për të luftuar përhapjen e dezinformatave.[10]

Aspekt tjetër i rëndësishëm i ndërmarrë nga BE-ja janë ndryshimet e bëra në vitin 2018 në Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (Directive (EU) 2018/1808), me theks të veçantë për edukimin medial.[11] Neni 33a i kësaj direktive konstaton se shtetet anëtare të BE-së do të promovojnë dhe marrin masa për zhvillimin e shkathtësive të edukimit medial, si dhe, po ashtu, detyron shtetet anëtare t’i raportojnë Komisionit Evropian çdo tre vjet për zbatimin e këtyre masave.[12] Gjithashtu, kjo direktivë, përmes nenit 28b, ka përcaktuar obligimet e platformave që shpërndajnë video për të marrë masa sa i përket edukimit medial dhe për ngritjen e vetëdijes së përdoruesve të tyre.[13]

Sa i përket vendeve anëtare të BE-së, edukimi medial nuk është lëndë e veçantë në sistemet e tyre arsimore, me përjashtim të Luksemburgut që e aplikon atë në

[9] Viola, R. (21 shkurt 2023). Let's make Europe a stronghold of media literacy. Shkrim autorial i Drejtorit të Përgjithshëm për Rrjetet e Komunikimit, Përmbajtjes dhe Teknologjisë në Komisionin Evropian, Roberto Viola, publikuar në LinkedIn.

[10] Po aty.

[11] European Commission. (26 maj 2023). Media literacy.

[12] Directive 2018/1808. Directive (EU) 2018/1808 of the European Parliament and of the Council of 14 November 2018 amending Directive 2010/13/EU on the coordination of certain provisions laid down by law, regulation or administrative action in Member States concerning the provision of audiovisual media services (Audiovisual Media Services Directive) in view of changing market realities.

[13] Po aty.

formë të trajnimit obligues. Disa prej vendeve të BE-së (Çekia, Danimarka, Greqia, Hungaria, Italia, Malta, Polonia, Qiproja, Spanja dhe Suedia) e kanë kombinuar edukimin medial me njohjet digjitale. Në Estoni, edukimi medial është i shkrirë në lëndën “Kompetenca digjitale”, në të cilën përveç teknologjisë informative, mësohet edhe për edukimin mbi informacionin, bashkëpunimin online, krijimin e përmbajtjes digjitale, sigurinë online dhe zgjidhjen e problemeve. Ndërkaq, Finlanda që njihet për sistem të avancuar të arsimit parauniversitar, edukimin medial e ka integruar në katër lëndë të ndryshme mësimore: matematikë, histori, art dhe gjuhë finlandeze. Nga ana tjetër, shtetet tjera të BE-së, si Franca dhe Sllovenia, e trajtojnë çështjen e edukimit mbi median dhe informacionin si lëndë zgjedhore në sistemin arsimor, ndonëse në Slloveni ajo trajtohet edhe në lëndë të tjera (gjuhën amtare dhe edukatën qytetare).[14]

1.3. Këshilli i Evropës (KiE)

Sipas perspektivës së KiE-së, edukimi medial dhe i informimit (EMI) është mjete kryesor për fuqizimin e qytetarëve dhe shoqërive për të marrë pjesë dhe kontribuar për njohuritë globale. Në pajtim me këtë përcaktim, KiE-ja i sheh si jashtëzakonisht të rëndësishme këto aspekte: qytetarët të zhvillojnë shkathtësitë njohëse, teknike dhe shoqërore për t’u mundësuar atyre qasje efikase dhe të analizojnë në mënyrë kritike përmbajtjet mediale; të jenë të informuar se cilat media i përdorin dhe në çfarë mënyre duhet të përdoren ato; t’i kuptojnë pasojat etike të mediave dhe teknologjive të reja, si dhe ta zhvillojnë komunikimin në mënyrë efikase, duke përfshirë këtu edhe krijimin e përmbajtjeve të caktuara përmes mediave. Për më tepër, dy objektivat kryesore të KiE-së në këtë drejtim janë përfshirja e edukimit medial dhe të informimit në kornizat institucionale dhe ofrimi i mjeteve për fuqizimin e përdoruesve individualë të mediave të të gjitha moshave dhe sferave të jetës. KiE-ja gjatë dy dekadave të fundit ka qenë e angazhuar në publikimin e instrumenteve, politikave, studimeve dhe aktiviteteve që kanë pasur për qëllim përmirësimin e edukimit medial dhe të informimit në Evropë. Po ashtu, udhëzuesit e KiE-së në këtë fushë janë përfshirë në shumë prej instrumenteve të kësaj organizate që i drejtohen shteteve, politikëbërësve dhe akterëve publikë dhe privatë që kanë përgjegjësi në mjedisin digjital në ndërlidhje me fushat si edukimi dhe mësimi i vazhdueshëm, fëmijët dhe të rinjtë, mediat etj.[15]

[14] <https://www.youtube.com/watch?v=uOqPrMztMuU&t=4s>

[15] [Council of Europe. Media Literacy.](#)

2. ANALIZË E KONTEKSTIT TË EDUKIMIT MEDIAL NË KOSOVË

Ky seksion i raportit shqyrton dhe analizon çështjen e edukimit medial në Kosovë, veçanërisht nga perspektiva e arsimit publik parauniversitar (shkollat fillore dhe të mesme) për edukimin e nxënësve me temën e edukimit medial.

Deri më tash nuk ka ndonjë nismë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme nga ana e institucioneve publike të Kosovës për ta trajtuar edukimin medial si nevojë urgjente për pajisjen e nxënësve dhe gjeneratave të reja me shkathtësi për shfrytëzimin e dobive dhe përfitimet e teknologjisë e mediave, si dhe për t'u mbrojtur dhe parandaluar kërcënimet dhe rreziqet që mund të vijnë nga to. Pavarësisht nga disa lëvizje të Ministrisë së Arsimit, Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit (MASHTI), për trajtimin e edukimit medial si temë ndërkurrikulare nëpër lëndë të ndryshme mësimore, kjo megjithatë nuk është ende prioritet i institucioneve shtetërore. Pasojat nga kjo mund të jenë shumëdimensionale dhe të paparashikueshme në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë për gjeneratat e reja, veçanërisht për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Ndryshe prej institucioneve arsimore, gjatë viteve të fundit në Kosovë, kjo çështje është trajtuar me më shumë vëmendje nga mekanizma jostitucionale e joqeveritare në bazë të nismave të vullnetit të mirë, kryesisht nga donatorë dhe organizata joqeveritare të ndryshme, përmes trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera. Megjithatë, për arsye të ndryshme, as kjo qasje nuk po bëhet në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme.

Njëri prej treguesve më të saktë se në çfarë gjendje është sistemi i arsimit, mësimdhënia dhe mësimnxënia në lidhje me mendimin kritik në shkollat fillore e të mesme tash e më shumë se dy dekada është testi PISA për vitin 2022, i cili ka nxjerrë me rezultat jashtëzakonisht të dobët nxënësit kosovarë. Duke vlerësuar kompetencën e nxënësve të moshës 15-vjeçare në lexim, matematikë dhe shkencë, PISA përmes metodologjisë së vet, ka renditur Kosovën në vendin 78-të nga 80 vendet pjesëmarrëse duke treguar rezultat të dobët në të tri këto fusha – vendin e 76-të për lexim, vendin e 77-të për shkencë dhe të 74-tin për matematikë.[16] Përmes testit PISA maten njohuritë e nxënësve për të zgjidhur

[16] Telegrafi. (Dhjetor 2023). [Kosova pothuajse "në fund të pusit", publikohen rezultatet e testit PISA.](#)

probleme komplekse, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të komunikojnë në mënyrë efektive. [AH1] Sipas rezultateve për Kosovën, del se nxënësit kosovarë përballen me sfida të mëdha në arritjen e këtyre shkathtësive tepër të nevojshme dhe çështja e mendimit kritik mes tjerash është fusha ku duhet bërë intervenim urgjent në arsimin parauniversitar për gjeneratat e reja.[17] Ndërlidhja e testit PISA me edukimin medial në Kosovë qëndron në konstatimin e raportit të këtij mekanizmi se nxënësit kosovarë (të moshës 15-vjeç) pothuajse nuk mund të kuptojnë tekste të gjata, të merren me koncepte që janë abstrakte ose kundërintuitive, si dhe të bëjnë dallimin ndërmjet faktit dhe opinionit, bazuar në shenja të nënkuptuara lidhur me përmbajtjen ose burimin e informacionit.[18]

Edhe Indeksi Evropian për Edukim Medial, në vitin 2023, ka renditur Kosovën në fund të listës sa i përket kësaj teme. Ky indeks është zhvilluar nga Instituti për Shoqëri të Hapur në Sofje dhe që nga viti 2017 mat edukimin medial në vendet evropiane përmes këtyre indikatorëve të ndryshëm të edukimit medial: niveli i edukimit, gjendja e mediave, besimi në shoqëri dhe përdorimi i mjeteve të reja për pjesëmarrje.[19] Matjet e bëra nga ky indeks më 2023 tregojnë se prej 41 vendeve evropiane, në të cilat janë bërë matjet për edukimin medial, Kosova është renditur e parafundit në vendin e 40 me vetëm 21 pikë.[20] Më keq se Kosova është vetëm Gjeorgjia e renditur në vendin e fundit (41) me 20 pikë. As vendet tjera të Ballkanit Perëndimor nuk qëndrojnë aq mirë, ndonëse renditen pak më lart se Kosova (Maqedonia e Veriut në vendin e 39 me 22 pikë, Shqipëria në vendin e 38 me 23 pikë, Bosnja dhe Hercegovina në vendin e 37 me 24 pikë, Mali i Zi më lart në vendin e 33 me 32 pikë dhe Serbia në vendin e 31 me 33 pikë). Ndërsa, në vendin e parë është Finlanda (74 pikë), pasuar nga Danimarka (73 pikë), Norvegjia (72 pikë), Estonia (71 pikë), Suedia (71 pikë), Irlanda (70 pikë) etj.[21]

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2023, rreth 98.06 për qind e ekonomive familjare kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2023[1] që është një përqindje shumë e lartë e qasjes dhe mundësisë së përdorimit të internetit në Kosovë. Grupmosha prej 16-24 vjeç është ajo që

[17] Intervistë me Muhamet Hajrullahun, Kryeredaktor i Telegrafit. 8 prill 2024.

[18] OECD. (2023). PISA 2022 Results: Factsheets – Kosovo, f. 3.

[19] Open Society Institute - Sofia. (June 2023). The Media Literacy Index 2023, f. 4.

[20] Po aty, f. 7.

[21] Po aty.

[22] Agjencia e Statistikave të Kosovës. (20 tetor 2023). Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare 2023, f. 1.

përdor më së shumti internetin, prej 21.5 për qind, pasuar nga 21.4 për qind nga grupmosha prej 25-34 vjeç, ndërsa katër grupmoshat tjera përdorin internetin në masë më të vogël prej 19 për qind e më pak në krahasim me dy grupmoshat paraprahe.[23] Sipas statistikave zyrtare, qytetarët në Kosovë përdorin më së shumti telefonat mobilë për t'u qasur në internet, në masën prej 94.8 për qind, dhe shumë pak pajisjet tjera si laptopët (22.1 për qind), kompjuterat/desktopët (11.9 përqind) dhe tabletët (9.7 për qind).[24] Ky është një tregues tjetër, po ashtu i depërtimit dhe përdorimit masiv të internetit në Kosovë, jo vetëm nga të rritur, por edhe nga nxënësit e shkollave të mesme (duke filluar nga personat në moshën prej 16-vjeç e tutje). Ata i ekspozohen drejtpërdrejt përmbajtjes në internet duke shfletuar faqe të ndryshme, veçanërisht atyre të krijuara dhe shpërndara në mediat sociale dhe mediat online përmes përdorimit të telefonave mobilë, duke përfshirë edhe përmbajtje si dezinformata dhe lajme të rreme, të cilat tashmë mund të krijohen dhe shpërndahen lehtësisht përmes mediave.[25] Ky depërtim i lartë i internetit në Kosovë shtron nevojën urgjente për ta vendosur edukimin medial si prioritetin kryesor nga ana e institucioneve shtetërore që janë të angazhuara në formulimin dhe zbatimin e politikave arsimore në shkollat fillore dhe të mesme në vend.

Pavarësisht qasjes, përdorimit dhe depërtimit pothuajse absolut të internetit në Kosovë, të dhënat zyrtare nga MASHTI, të publikuara në Strategjinë për Arsim 2022-2026, dëshmojnë se institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) [26] në Kosovë janë shumë prapa sa i përket digjitalizimit dhe shfrytëzimit të teknologjisë informative për qëllime shkollore dhe arsimore. Prej gjithsej 1,058 objekteve të IEAA-ve publike në Kosovë, 705 prej tyre (ose 66.64 për qind) kanë qasje në internet kundrejt 305 (ose 33.36 për qind) objekteve të tjera të IEAA-ve publike që nuk kanë. Edhe pse shumica e objekteve shkollore në Kosovë rezultojnë se kanë qasje në internet, megjithatë MASHTI ka vënë në dukje se ato “në shumicën e rasteve nuk ofrojnë internet në tërë hapësirën shkollore, por vetëm në zyrat e caktuara të personelit dhe, eventualisht në kabinetet e TIK-ut”. [27] Gjendje më alarmante është sa i përket numrit të kompjuterëve, sepse

[23] Po aty, f. 2.

[24] Po aty, f. 3.

[25] Intervistë me Muhamet Hajrullahun, Kryeredaktor i Telegrafit. 8 prill 2024.

[26] Me IEAA nënkuptohen kopshtet/çerdhet, shkollat fillore, shkollat e mesme të ulëta, shkollat e mesme të larta të përgjithshme (gjimnazet), shkollat e mesme të larta profesionale, institucionet që ofrojnë arsim dhe aftësim për të rritur etj.

[27] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). Strategjia e Arsimit 2022-2026. Prishtinë, f. 54.

të gjitha IEAA-të publike kanë vetëm 9,138 kompjuterë. Kjo i bie 1 kompjuter për rreth 35 nxënës, ose 9,138 kompjuterë për 320,000 nxënës në arsimin parauniversitar. Gjendje aspak e mirë nuk është as sa i përket pajisjeve të tjera, si projektorë (1,753), ekrane digjitale (191), televizorë smart (502), makina fotokopjuese (727), printerë (851), tabletë (247), skanerë (11) etj.[28] Këto të dhëna shqetësuese janë të shtatorit të vitit 2021 të cilave u referohet Strategjia e Arsimit, ndërsa nuk dihet nëse prej asaj periudhe dhe deri më tash ka pasur ndonjë përmirësim në këtë aspekt. Të dhënat e vetme zyrtare tregojnë se prej vitit 2021 ka pasur rënie të numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar – prej rreth 320,000 nxënësve në shtator të vitit 2021, në 314,006 nxënës në vitin shkollor 2023/2024.[29] Kjo shpërfaq, po ashtu, se në shkollat e arsimit parauniversitar ende kultivohet qasja tradicionale dhe mekanike e arsimit me mjete të vjetruara duke mos i dhënë përparësi e as prioritet teknologjisë digjitale për ta lehtësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien nëpër shkolla.[30]

2.1. Edukimi medial në arsimin parauniversitar në Kosovë

Që nga viti 2022, MASHTI punon me Strategjinë e re të Arsimit 2022-2026, i cili është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë. Strategjia ka gjithsej pesë fusha dhe arsimit parauniversitar është njëra nga to, ndërsa dokumenti në vetvete përmban pesë objektiva strategjike[31] dhe asnjë prej këtyre objektivave nuk e trajton në mënyrë të veçantë edukimin medial. Ndonëse objektiva e pestë strategjike është “përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital”,[32] e cila ndërlidhet me edukimin medial, kjo e fundit nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

[28] Po aty, f. 55.

[29] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (Janar 2024). Shënime statistikore: të dhëna mbi arsimin parauniversitar 2023/24, f. 2.

[30] Intervistë me Dafina Jegenin, Gazetare në Klan Kosova / Mësimdhënëse e lëndës me zgjedhje “Edukimi Medial” në “Princeton School of Prishtina”. 19 prill 2024.

[31] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). Strategjia e Arsimit 2022-2026. Prishtinë, fq. 11-13.

[32] Po aty, f. 13.

Sa i përket objektivit strategjik të Strategjisë së Arsimit për përdorimin e teknologjisë digjitale në sistemin arsimor, në këtë dokument thuhet se deri në vitin 2026 do të punohet në pesë drejtime për digjitalizimin e sistemi arsimor[33]:

- krijimin dhe funksionalizimin e një platforme digjitale gjithëpërfshirëse e të centralizuar për fushën e arsimit;
- përgatitjen dhe prodhimin e materialeve mësimore digjitale shumëdimensionale e cilësore për nivele, klasë, lëndë e lloje të ndryshme;
- furnizimin e institucioneve arsimore me rrjete të internetit cilësor dhe me pajisje teknologjike të nevojshme;
- kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve; dhe
- krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

Edhe pse ekziston ndërlidhje e drejtpërdrejtë, ose e tërthortë mes edukimit mbi median dhe informacionin me digjitalizimin e sistemit arsimor, në tërësinë e Strategjisë së Arsimit fjala “media” përdoret vetëm tre herë. Rasti më konkret kur strategjia i referohet edukimit medial (ndonëse jo me këtë emër në mënyrë të veçantë) është në kuadër të nënseksionit “Kompetenca digjitale” (shih f. 55 në Strategjinë e Arsimit 2022-2026) për digjitalizimin e arsimit.

Me kompetencë digjitale nënkuptohet aftësia për shfrytëzim dhe ndërveprim konfident, kritik e të përgjegjshëm me teknologji digjitale me qëllim të të nxënit, të kryerjes së detyrave të punës dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Për më tepër, kompetenca digjitale “përfshin të kuptuarit e informacionit dhe të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin, të kuptuarit e medias, krijimin e përmbajtjes digjitale (përfshirë kodimin), sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe sigurinë në internet), çështjet që kanë të bëjnë me pronën intelektuale, si dhe zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik e krijues”[34].

[33] Po aty.

[34] Po aty, f. 55.

Ky përkufizim i kompetencës digjitale është shumë i gjerë dhe me këtë mund të nënkuptohet shumëçka, ndërsa “të kuptuarit e medias” përmendet shkarazi në mesin e shumë temave të tjera pa u zhvilluar tutje si koncept dhe përmbajtje në funksion të fëmijëve, nxënësve dhe mësimitdhënësve. Megjithatë, MASHTI, përmes këtij dokumenti strategjik, ka vlerësuar se Kosova duhet të investojë në aspektin e kompetencës digjitale për kategoritë e fëmijëve, nxënësve, studentëve, edukatorëve dhe mësimitdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit[35] duke konstatuar në këtë mënyrë se është mbrapa për sa i përket temave që mbulohen nga kompetenca digjitale, përfshirë median. Si masa që do të ndërmerret për zhvillimin e kultivimin e kompetencës digjitale, MASHTI ka paraparë zyrtarizimin e tre dokumenteve bazë të BE-së për kompetencën digjitale në Kosovë, siç janë Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp), për Mësimitdhënësit (DigCompEdu) dhe për Organizatat Arsimore (DigCompOrg).

2.1.1. Kurrikula dhe plan-programet mësimore në Kosovë

Sa i përket arsimit parauniversitar në Kosovë, në kurrikulën dhe plan-programet mësimore aktuale të shkollave fillore dhe të mesme (të nivelit të ulët dhe të lartë, si dhe shkollat profesionale), nuk ka pasur ndonjëherë e as nuk ka ndonjë lëndë të veçantë për edukimin medial dhe si e tillë ajo nuk është e obligueshme për nxënësit kosovarë. Kjo është konfirmuar edhe nga zyrtarë të lartë të MASHTI-t, të cilët kanë konstatuar se megjithëse nuk ka lëndë të veçantë për këtë tematikë, kurrikula aktuale mësimore e trajton edukimin medial si “çështje ndërkurrikulare”. [36]

Sipas MASHTI-t, që i bën politikat mbi të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, përfshirja e edukimit medial në kurrikulë dhe plan-programe në formë ndërkurrikulare nënkupton se të gjithë mësimitdhënësit kosovarë duhet të përfshijnë tema të edukimit medial në lëndët e tyre, pavarësisht lëndëve që japin para nxënësve, qoftë në shkenca shoqërore, apo natyrore. Vendosja e edukimit medial në kurrikulë si çështje ndërkurrikulare, sipas zyrtarëve të MASHTI-t, të

[35] Po aty.

[36] Intervistë me zyrtarët e Divizionit për Plan-programe dhe Teskte Shkollore në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 26 prill 2024.

intervistuar për qëllimet e këtij raporti, ka buruar si pasojë e harmonizimit të politikave arsimore të Kosovë me ato globale. Kjo qasje është bazuar në kërkesën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi zhvillimin e qëndrueshëm edhe në fushën e arsimit, mes tjerash, që përmes çështjeve ndërkurrikulare të zhvillohen shkathtësitë e nxënësve për edukim medial dhe mendim kritik, në mënyrë të vazhdueshme përmes lëndëve të ndryshme, si dhe jo përmes ndonjë lënde të veçantë mbi këto tema.[37]

Për më tepër, nga MASHTI janë deklaruar kundër vendosjes së një lënde të veçantë vetëm për edukimin medial, sepse kjo, sipas Ministrisë, vetëm e “shabllonizon” edukimin medial përderisa qëllimi i kurrikulës është zhvillimi i shkathtësive praktike (dhe jo teorike apo abstrakte) të nxënësve për edukim medial përmes lëndëve të ndryshme dhe rrjedhimisht edhe të mendimit kritik në formë të vazhdueshme.

Edhe niveli politik, përkatësisht ministrja e MASHTI-t, Arbërie Nagavci, gjatë deklarimeve publike nuk është shprehur në favor të përfshirjes së edukimit medial si lëndë e obligueshme mësimore në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë.[38] Duke konfirmuar se edukimi medial është i shtrirë në lëndët e tjera në mënyrë ndërkurrikulare, siç përcaktohet me kurrikulën aktuale, ministrja Nagavci nuk është shprehur optimiste për ta përfshirë atë si lëndë mësimore, me frikën se mund të rrezikojë ekuilibrin e nevojave për lëndët ekzistuese shkollore dhe për shkak se ka kërkesa për të përfshirë edhe lëndë të tjera të veçanta shkollore përveç edukimit medial. Në këtë mënyrë, nuk duket se ka vullnet politik për ndryshime të kurrikulës për shkollat fillore dhe të mesme me qëllim të përfshirjes së edukimit medial si lëndë specifike shkollore. Si zgjidhje, ministrja Nagavci ka përmendur se “ka lëndë të ndryshme ku ka njësi specifike që adresojnë çështjen e edukimit medial” dhe se ajo është e përfshirë në lëndët me zgjedhje nëpër shkolla, gjegjësisht në lëndët “Gjuhë dhe letërsi” dhe “Edukata qytetare”[39]. Derisa nuk ka të dhëna zyrtare për efektet që ka prodhuar edukimi medial si çështje ndërkurrikulare, një nga vërejtjet dhe kritikrat kryesore të njohësve të edukimit medial, gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile është se trajtimi i edukimit medial në arsimin parauniversitar vetëm si temë ndërkurrikulare është e pamjaftueshme. Ata sugjerojnë se kjo nuk mund të

[37] Po aty.

[38] Koha.Net. (18 korrik 2022). [Nagavci: Kosova duhet të avancojë në kontekstin e edukimit medial.](#)

[39] OSCE Mission in Kosovo. (7 tetor 2022). [“EduMedia”, Episode 6 - The need for the inclusion of Media Literacy in schools.](#)

zëvendësojë në asnjë mënyrë edukimin medial si një lëndë e veçantë mësimore dhe e obligueshme për të gjitha institucionet shkollore të arsimit parauniversitar.

Sipas tyre, mospërfshirja në vazhdimësi e edukimit medial nga MASHTI në kurrikulë dhe plan-programe mësimore si lëndë e veçantë dhe e obligueshme mësimore është mungesë e vullnetit institucional për ta trajtuar seriozisht dhe në thelb edukimin medial për të nxitur mendimin kritik të nxënësve.[40] Njohësit e edukimit medial në Kosovë kritikojnë se arsyet kryesore mbi refuzimin e MASHTI-t për mospërfshirjen e edukimit medial si lëndë e veçantë janë: i) meqë vendimi i takon nivelit politik, atëherë bartësit politikë (përfshirë MASHTI-n) nuk janë të interesuar për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve për edukimin medial dhe mendimin kritik sepse kanë për synim të shfrytëzojnë të rinjtë për konsum të brendshëm politik[41], si dhe ii) ndryshimi i kurrikulës potencialisht do të hapte probleme të reja jashtë edukimit medial sepse do të shtrohej nevoja që edhe lëndë të tjera të reja të përfshihen si lëndë mësimore të rregullta[42]. Megjithatë, organizata të ndryshme joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë (si misioni i OSBE-së në Kosovë), në vazhdimësi avokojnë me synimin final për integrimin e edukimit medial si lëndë e veçantë në procesin e rregullt mësimor.[43]

Njohësit e çështjeve pedagogjike dhe të arsimit parauniversitar sugjerojnë se përfshirja e edukimit medial do të kërkonte edhe aftësim e trajnim sistematik të mësimdhënësve të rinj dhe kjo do të rezultonte në angazhim maksimal për MASHTI-n dhe institucionet tjera arsimore në kualifikimin e stafit adekuat në procesin e mësimdhënies për edukimin medial,[44] ndërsa në këtë drejtim nuk ka lëvizje serioze dhe konkrete. Për më tepër, MASHTI kritikohet edhe për shkak se ka mbetur prapa në ndjekjen e trendëve të teknologjisë informative dhe digjitalizimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies si parakushte kyçe për t'u përshtatur me kushtet moderne të arsimit.[45] Krahas kësaj, kërkohet me

[40] Intervistë me Arben Hajredinajn, Udhëheqës i Seksionit për Media të Misionit të OSBE-së në Kosovë. 15 prill 2024.

[41] Intervistë me Alban Zenelin, Profesor Asistent në Departamentin e Gazetarisë, Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. 3 qershor 2024.

[42] Po aty.

[43] Intervistë me Arben Hajredinajn, Udhëheqës i Seksionit për Media të Misionit të OSBE-së në Kosovë. 15 prill 2024.

[44] Intervistë me Rinor Qehajën, Drejtor Ekzekutiv i Institutit EdGuard. 11 prill 2024.

[45] Intervistë me Dafina Jegenin, Gazetare në Klan Kosova / Mësimdhënëse e lëndës me zgjedhje "Edukimi Medial" në "Princeton School of Prishtina". 19 prill 2024.

ngulm që edukimi medial të bëhet lëndë e rregullt mësimore në sistemin arsimor për ndërgjegjësimin e nxënësve lidhur me efektet pozitive e negative jo vetëm të mediave (mediave online dhe mediave sociale), por edhe në kombinim me teknologjitë digjitale nga rreziku në rritje i inteligjencës artificiale dhe formave tjera të digjitalizimit.[46]

Edhe pse nuk është lëndë e obligueshme mësimore në institucionet shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm, edukimi medial ligjërohet si lëndë e veçantë ose mësim me zgjedhje në disa shkolla të Kosovës, kryesisht në ato të mesme. Mësimi, ose lëndët me zgjedhje (lëndë zgjedhore) nënkupton se mësimdhënësit në bashkëpunim me institucionet shkollore dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë të drejtë, me kurrikulën aktuale, të përfshijnë lëndë të ndryshme me zgjedhje në plan-programin mësimor.[47] Kjo është kompetencë e komunave dhe funksionon në atë mënyrë që shkollat bëjnë propozim të programit mësimor për lëndët me zgjedhje lidhur me nevojat e tyre, aplikojnë në komuna, ndërsa komunat krijojnë një komision për vlerësimin e programeve të propozuara nga shkollat dhe pas miratimit, komuna vendosë për caktimin e lëndës me zgjedhje.

Përveç kësaj, pas ofrimit të lëndëve me zgjedhje nga shkollat, nxënësit mund të zgjedhin se për cilat lëndë me zgjedhje kanë më shumë interesim për të vijuar gjatë një viti mësimor.[48] Megjithatë, nuk dihet numri i shkollave dhe mësimdhënësve që kanë si lëndë zgjedhore edukimin medial dhe as numri i nxënësve që kanë marrë edukimin medial si mësim me zgjedhje. Sfida kryesore sa i përket mësimi/lëndëve me zgjedhje qëndron në atë se mësimdhënësve u ngarkohet e tërë barra dhe përgjegjësia për përgatitjen e tekstit dhe materialit mësimor gjatë orëve të mësimi, e cila bart në vete edhe koston financiare përveç anës përmbajtësore.[49] Sa i përket teksteve shkollore, misioni i OSBE-së në Kosovë, gjatë viteve 2016-2022, ka shpërndarë 400 kopje të teksteve të edukimit medial tek mësuesit dhe nxënësit në gjuhën shqipe, si dhe 300 tekste tjera shkollore mësuesve dhe nxënësve të komuniteteve pakicë në gjuhën serbe, turke dhe rome.[50] Si rezultat i punës së OSBE-së në Kosovë, tre shkolla fillore

[46] Intervistë me Muhamet Hajrullahun, Kryeredaktor i Telegrafit. 8 prill 2024.

[47] Intervistë me zyrtarët e Divizionit për Plan-programe dhe Teskte Shkollore në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 26 prill 2024.

[48] Po aty.

[49] Intervistë me Kushtrim Bekteshin, Mësimdhënësi i lëndës me zgjedhje "Edukimi Medial" në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. 20 prill 2024.

[50] Misioni i OSBE-së në Kosovë. Iniciativat për Edukim Medial dhe Informativ.

dhe të mesme në vend e kanë përfshirë edukimin mbi median dhe informacionin si lëndë zgjedhore.[51]

Ndërkaq, procesi i zbatimit të kurrikulës në vetvete është sfidues dhe disa prej tyre shqyrtohen në këtë pjesë të raportit. Një nga to është përshtatshmëria e mësimdhënësve me kurrikulën mësimore dhe kuptimi i kësaj të fundit nga mësimdhënësit, veçanërisht për çështjet ndërkurrikulare në kuadër të të cilave përfshihet edukimi medial. Sipas kurrikulës, çdo mësimdhënës është i obliguar ta trajtojë edukimin medial në bazë të lëndëve të tyre, por niveli i përfshirjes së edukimit medial si temë ndërkurrikulare mbetet në vullnetin e mësimdhënësve, sipas MASHTI-t [52]. Aktualisht nuk dihet se në çfarë forme është i lidhur edukimi medial me lëndët e ndryshme mësimore.[53] Prandaj, edhe zbatimi i kurrikulës nga ana e shkollave dhe në mënyrë të veçantë nga mësimdhënësit paraqet një problematikë tjetër, për të cilën mungojnë informata dhe të dhëna empirike. Nuk dihen as kapacitetet në institucionet shkollore të Kosovës lidhur me edukimin medial, gjegjësisht sa janë të përgatitur mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme për temat e edukimit medial sepse prioriteti i tyre kryesor nuk është edukimi medial duke e ditur se një pjesë e madhe e tyre vijnë nga fusha të tjera të mësimdhënies, si matematikë, fizikë, kimi, biologji etj., të cilat dallojnë shumë nga shkencat shoqërore, si gjuha shqipe, sociologjia, filozofia, historia dhe lëndë të tjera shoqërore që kanë ndërlidhje me edukim medial. Ekspertë të edukimit medial, që kanë trajnuar mësimdhënësit e arsimit parauniversitar kanë konstatuar se, me disa përjashtime të vogla, mësimdhënësit nuk i kanë shkathtësitë e duhura për edukim medial me qëllim të bartjes së atyre njohurive tek nxënësit në këtë fushë.[54] Duke e ditur se qasja e mësimdhënies nga një pjesë e madhe e mësimdhënësve në Kosovë është mekanike dhe tradicionale, [55] atëherë ndërlidhja e lëndëve mësimore në formë ndërkurrikulare me edukimin medial dhe mendim kritik kërkon angazhim, por edhe investim më të madh nga MASHTI dhe institucionet tjera arsimore për ta ngritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies në zbatim të kurrikulës mësimore.

[51] Po aty.

[52] Intervistë me zyrtarët e Divizionit për Plan-programe dhe Tekste Shkollore në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 26 prill 2024.

[53] Po aty.

[54] Intervistë me Alban Zenelin, Profesor Asistent në Departamentin e Gazetarisë, Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. 3 qershor 2024.

[55] Intervistë me Dafina Jegenin, Gazetare në Klan Kosova / Mësimdhënëse e lëndës me zgjedhje "Edukimi Medial" në "Princeton School of Prishtina". 19 prill 2024.

Për vlerësimin e zbatimit të kurrikulës është e nevojshme mbikëqyrja sistematike dhe e vazhdueshme e mësimdhënies nga mekanizma përkatës. Në MASHTI kanë konstatuar se është ende herët të vlerësohet zbatimi i kurrikulës sepse nuk kanë kaluar më shumë dy vjet kur ka nisur zbatimi i saj.[56] Monitorimi bëhet nga ana e Inspektoratit të Arsimit, i cili është në varësi të drejtpërdrejtë të ministres së MASHTI-t dhe funksionon në nivelin qendror në Prishtinë dhe në rajonet e Kosovës (Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Gjakovë).[57] Derisa nuk ka të dhëna për nivelin e zbatimit të edukimit medial në shkollat e Kosovës si çështje ndërkurrikulare, përgjegjësi sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të kurrikulës nga ana e mësimdhënësve kanë edhe drejtoritë e shkollave dhe Drejtoritë Komunale për Arsim. Në këtë drejtim, nuk dihet se çfarë aktivitete kanë ndërmarrë këta dy mekanizma për ta mbikëqyrur zbatimin e kurrikulës nga mësimdhënësit sa i përket edukimit medial si çështje ndërkurrikulare, si dhe sa efikas janë në mbikëqyrjen e mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme. Edhe Strategjia për Arsim konfirmon se ekzistojnë probleme serioze lidhur me efikasitetin e organeve mbikëqyrëse të arsimit, duke pranuar se dobësia më e madhe e arsimit parauniversitar është sigurimi i cilësisë.[58]

2.1.2. Trajnimet e mësimdhënësve për edukim medial

Komponentë tjetër e rëndësishme janë edhe trajnimet që organizohen për temat e edukimit medial, të cilat kryesisht mbahen nga organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë. Këto trajnime kanë për qëllim të aftësojnë profesionalisht mësimdhënësit kosovarë për edukim medial në funksion të zbatimit të njohurive që i fitojnë në trajnime në procesin e mësimdhënies gjatë orëve mësimore dhe për t'i transmetuar ato tek nxënësit e tyre. MASHTI, në kuadër të aktiviteteve për trajnim të mësimdhënësve, shpall thirrje të hapura dhe organizatat që synojnë të organizojnë trajnime të tilla duhet të aplikojnë në këto thirrje me programet e tyre të trajnimit, të cilat duhet të miratohen nga MASHTI për trajnim të mësimdhënësve.[59]

[56] Intervistë me zyrtarët e Divizionit për Plan-programe dhe Tekste Shkollore në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 26 prill 2024.

[57] [Ligji Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.](#)

[58] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#). Prishtinë, f. 64.

[59] Intervistë me zyrtarët e Divizionit për zhvillim profesional të mësimdhënësve në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 29 prill 2024.

Organizatat, programet e të cilave janë miratuar për organizim të trajnimeve në fushën e edukimit medial për mësimdhënësit, janë Qendra për Arsim e Kosovës (QAK/KEC) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK). Gjatë viteve 2018-2023, SBASHK-u ka trajnuar 3,500 mësimdhënës të arsimit parauniversitar në Kosovë (shkolla fillore dhe shkolla të mesme) lidhur me shkathtësitë e tyre mbi rolin e medias, demokratizimin, çrregullimin informativ, dezinformimin, keqfunksionet e mediave dhe edukimin medial.[60]

Paraprakisht trajnime të tilla kanë mbajtur edhe organizata joqeveritare (Dokufest, IPKO etj.), si dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, si UNICEF dhe misioni i OSBE-së në Kosovë. Kjo e fundit (OSBE), gjatë viteve 2016-2022, ka trajnuar 70 mësimdhënës të shkollave të mesme për konceptet e edukimit medial dhe ka organizuar ligjërata për 450 nxënës të 22 shkollave të mesme në lidhje me edukimin medial, mediat digjitale dhe informimin.[61]

Ndërkaq, MASHTI ka dy lloje të programeve të trajnimit[62]:

1. Programet themelore të trajnimeve që ndërlidhet drejtpërdrejt me mësimdhënie.
2. Programet plotësuese të trajnimeve, në të cilat, mes tjerash përfshihen edhe trajnimet e mësimdhënësve për edukim medial.

Dallimi kryesor mes këtyre dy programeve qëndron në atë se programet themelore për mësimdhënie kanë kohëzgjatje më të madhe dhe kanë orë më shumë për shkak se ndërlidhen direkt me mësimdhënie, gjegjësisht me lëndët ekzistuese (si gjuhë, matematikë e kështu me radhë). Kurse, programet plotësuese të trajnimeve i dedikohen temave ndërkurrikulare, siç është edukimi medial, ose tema tjera. Kjo nënkupton se programet plotësuese kanë kohëzgjatje më të shkurtër dhe kanë orë më pak të trajnimeve, sepse edukimi medial nuk është lëndë e veçantë në plan-programin mësimor, por trajtohet vetëm si temë ndërkurrikulare. Sipas zyrtarëve të MASHTI-t, një trajnim për edukimin medial zgjat mesatarisht 20 orë dhe atë jo më shumë se tri ditë (rreth 6 orë në ditë).[63]

[60] Intervistë me Alban Zenelin, Profesor Asistent në Departamentin e Gazetarisë, Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. 3 qershor 2024.

[61] Misioni i OSBE-së në Kosovë. [Iniciativat për Edukim Medial dhe Informativ](#).

[62] [Intervistë me zyrtarët e Divizionit për zhvillim profesional të mësimdhënësve në Departamentin për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, 29 prill 2024.](#)

[63] [Po aty.](#)

Kjo nënkupton se çështja e edukimit medial është dytësore, përderisa trajnimet në atë fushë janë vetëm plotësuese pa i dhënë vëmendjen dhe prioritetin e duhur, marrë parasysh trendët aktualë në këtë fushë.

Vështirësi tjetër sa i përket këtyre trajnimeve, me theks të veçantë atyre që organizohen për edukimin medial, janë edhe gjetja e financimit për mbajtjen e trajnimeve, më saktësisht zbatimi i programeve të trajnimit. Duke e ditur se programet e trajnimeve të miratuara nga MASHTI për edukim medial organizohen kryesisht nga organizata joqeveritare dhe MASHTI nuk i mbështet ato financiarisht, atëherë ato organizata janë të varura nga donatorët e huaj për financimin e aktiviteteve në lidhje me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës për temat e edukimit medial.[64] Në këtë rast, nëse organizatat joqeveritare nuk arrijnë të sigurojnë qëndrueshmëri financiare për aktivitetet e trajnimit, programet e trajnimit nuk arrijnë të zbatohen dhe, për më keq, nuk mbahen fare trajnimet e mësimdhënësve për edukimin medial pavarësisht se ato programe janë miratuar nga MASHTI.[65] Nga ana tjetër, pavarësisht se buxheti i MASHTI-t për vitin 2024 është mbi 100 milionë euro (100,120,951 euro), vetëm rreth 0.4% e këtij buxheti ose 393,747 euro është paraparë të shpenzohet për zërin buxhetor “Trajnimi i mësuesve”, i cili nuk dihet se ku do të shpenzohet saktësisht. Për më tepër, Ligji Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, nuk përcakton se ku do të shpenzohet ky buxhet i dedikuar për “trajnimin e mësuesve”. [66]

Sa i përket njohurive që fitojnë mësimdhënësit nga trajnimet, sfida mbetet mbikëqyrja e mësimdhënësve lidhur me zbatimin e njohurive të tyre tek nxënësit në fushën e edukimit medial. Mënyra më e lehtë duket se është ndërtimi i urave të komunikimit mes drejtorive të shkollave për të mbikëqyrur mësimdhënësit në drejtim të vetëdijesimit të nxënësve për edukimin medial nga këto programe trajnimi. Nuk ka të dhëna dhe informata të verifikuara nëse kjo ndodh dhe nëse ka ndonjë vlerësim për ndikimin e këtyre programeve të trajnimit tek procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informatat e dhëna nga MASHTI sugjerojnë se mësimdhënësit e rinj janë më të përgatitur dhe më të interesuar për zhvillim profesional për edukim medial, teknologji informative dhe digjitalizim në përgjithësi, ndërsa mësimdhënësit mbi moshën 55-vjeç kanë ngecje, veçanërisht në teknologji, qasje në informata dhe ka raste kur rezistojnë të reformohen.

[64] Po aty.

[65] Po aty.

[66] [Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.](#)

Përveç trajnimeve të mësimdhënësve, organizatat joqeveritare në bashkëpunim me institucionet universitare dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe të mbështetura nga komuniteti i donatorëve të huaj organizojnë trajnime të ndryshme për të rinjtë mbi tema të ndryshme të edukimit medial. Përmes tyre, këto organizata japin në vazhdimësi kontribut të theksuar në trajnimin e të rinjve që përfshijnë nxënës të shkollave të mesme dhe studentë kosovarë, për rëndësinë e edukimit medial, luftimin e lajmeve të rreme, teknologjinë informative, atë digjitale etj. Këto trajnime bëhen në mënyrë të pavarur nga organizata të shoqërisë civile, megjithëse nuk kanë qëndrueshmëri meqë varen nga mbështetja financiare e donatorëve të huaj për tema të ndryshme në ndërlidhje me edukimin medial.

REKOMANDIME

- MASHTI të angazhojë ekspertë për hartimin e kurrikulës së veçantë për edukimin medial, e cila pastaj shërben si bazament për plotësim/ndryshimin e kurrikulës dhe plan-programeve mësimore.
- MASHTI të trajtojë me prioritet dhe urgjencë çështjen e edukimit medial në shkollat fillore dhe të mesme përmes njërës nga këto dy opsione:
 - i) Opsioni 1: Të plotësojë/ndryshojë kurrikulën dhe plan-programet mësimore aktuale për ta përfshirë edukimin medial si lëndë e veçantë mësimore dhe të detyrueshme për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar me synim të pajisjes së nxënësve me shkathtësi të edukimit medial; ose
 - ii) Opsioni 2: Në rast të mungesës së vullnetit politik dhe institucional për plotësimin/ndryshimin e kurrikulës mësimore, atëherë të bëhet rishikimi i materialeve dhe librave mësimorë për ta përfshirë edukimin medial si temë ndërkurrikulare në të gjitha lëndët mësimore dhe të ketë më shumë fond të orëve mësimore në të cilat trajtohet edukimi medial dhe mendimi kritik për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në këto dy tema. Me këtë do të garantohej (të paktën nominalisht) zbatimin e kurrikulës aktuale mësimore për trajtimin e edukimit medial si temë ndërkurrikulare në procesin e mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë. Të krijohet një udhëzues se si të zbatohen temat e edukimit medial në formë ndërkurrikulare nëpër lëndët e rregullta mësimore për t'ua lehtësuar mësimdhënësve ndërveprimin e lëndëve të tyre me edukimin medial dhe për t'i bërë më atraktive për nxënësit orët mësimore.
- MASHTI të marrë përsipër përgjegjësitë që i takojnë për avancimin e edukimit medial dhe koordinimin e nismave që shprijnë në konsolidimin e edukimit medial dhe integrimin e plotë në arsim parauniversitar përmes afateve kohore të përcaktuara për arritjen e rezultateve konkrete.
- MASHTI të angazhojë ekspertë për hartimin e teksteve shkollore për nxënës dhe mësimdhënës për edukimin medial.

- MASHTI të kërkojë angazhim maksimal nga Departamenti i Gazetarisë në kuadër të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës ta zhvillojnë edukimin medial si lëndë mësimore në arsimin parauniversitar dhe ta zgjerojnë atë edhe në universitetet tjera publike. Po ashtu, të fuqizohet Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës për aftësimin e gjeneratave të reja të mësimdhënësve për edukimin medial.
- MASHTI të rishqyrtojë seriozisht nevojën për hartimin e strategjisë për edukimin medial dhe të shikojë se ku ka mbetur procesi i nisur më herët për draftimin e një dokumenti të tillë strategjik. Strategjia aktuale për arsim e trajton në mënyrë të mangët, sipërfaqësisht dhe pamjaftueshëm çështjen e edukimit medial në kuadër të digjitalizimit. Prandaj, kjo çështje duhet të trajtohet përmes një strategjie kombëtare me plan konkret veprimi.
- Të përkrahet dhe nxitet edhe më shumë mësimi me zgjedhje për edukimin medial në Kosovë si lëndë zgjedhore në shkollat fillore dhe të mesme – në rast se nuk ka vullnet për ta bërë edukimin medial si lëndë të obligueshme mësimore. Po ashtu, duhet të ketë standardizim të materialeve mësimore për edukimin medial si lëndë zgjedhore për t'i shkarkuar nga kjo barrë mësimdhënësit dhe për të mos bërë improvizime në këtë drejtim, nga e cila më së shumti do të pësonin nxënësit.
- MASHTI duhet të udhëheqë procesin për vlerësimin e nevojave të shkollave në arsimin parauniversitar për edukimin medial, të identifikohen sfidat sa i përket kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve për edukimin medial dhe të ketë vlerësim të njohurive të tyre për ta përfshirë edukimin medial nëpër lëndët e tyre mësimore si temë ndërkurrikulare për t'i hapur rrugë pastaj përgatitjes së programeve specifike të trajnimit për mësimdhënësit mbi këtë temë me disa nivele të obligueshme për mësimdhënësit. Në mungesë të informatave se cilat janë nevojat e institucioneve shkollore në aspektin teknik-profesional, trajnimet që mbahen aktualisht mund të rezultojnë lehtësisht si të paefektshme dhe pa ndonjë ndikim të theksuar tek nxënësit për rëndësinë e edukimit medial, të informacionit dhe mendimit kritik në përgjithësi.
- MASHTI duhet të merret në mënyrë aktive në trajnimin e mësimdhënësve për edukimin medial. Këtë proces duhet ta udhëheqë MASHTI si bartës i politikave arsimore në vend dhe të mos i trajtojë trajnimet e edukimit medial për mësimdhënësit si programe plotësuese ose dytësore, por me prioritet të

lartë. Për më tepër, ky proces duhet të udhëhiqet institucionalisht dhe jo të mbetet në vullnetin e organizatave të sektorit joqeveritar, organizata të cilat nuk mbështeten financiarisht nga MASHTI dhe varen tërësisht nga donatorët e huaj për zbatimin e programeve të trajnimit. Për më tepër, MASHTI, në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe Departamentin e Gazetarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës, si dhe me sektorin joqeveritar (OJQ, media, ekspertë etj.), duhet të hartojë programe trajnimi me synim zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të shkollave fillore e të mesme në fushën e edukimit medial. Këto trajnime duhet të jenë afatgjata në aspektin kohor, të qëndrueshme në kuptimin përmbajtësor dhe financiarisht të mbështetura përmes ndonjë linje të veçantë buxhetore nga ana e MASHTI-t për sigurimin e cilësisë së mësimitdhënësve mbi temat e edukimit medial.

- Të fuqizohen mekanizmat aktualë ose në rast nevojë të krijohen mekanizma të rinj mbikëqyrës funksioni i të cilëve do të duhej të jetë jo vetëm mbikëqyrje teknike, por edhe profesionale: i) mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të kurrikulës dhe plan-programit mësimor nga mësimitdhënësit për trajtimin e edukimit medial si temë ndërkurrikulare, ii) mbikëqyrja e zbatimit të njohurive profesionale të fituara nga mësimitdhënësit gjatë trajnimeve dhe transmetimi i atyre njohurive tek nxënësit, dhe iii) këta mekanizma mbikëqyrës të raportojnë tek Qeveria e Kosovës/MASHTI dhe Kuvendi i Kosovës (komisioni përkatës parlamentar për arsim) çdo gjashtë muaj ose një herë në vit lidhur me rezultatet e mbikëqyrjes së arsimit parauniversitar në Kosovë në funksion të ngritjes së vetëdijes së nxënësve për edukimin medial, mendimin kritik, digjitalizimin, dobritë dhe rreziqet nga teknologjia digjitale etj.
- Të zbatohet në tërësi Strategjia për Arsim 2022-2026 për digjitalizimin e plotë të sistemit arsimor parauniversitar dhe të zhvillohen kapacitetet brenda shkollave për ndërveprim mes teknologjisë digjitale dhe edukimit medial për të mundësuar ndërgjegjësim sa më të madh të nxënësve lidhur efektet pozitive dhe negative të rolit të mediave, informacionit dhe teknologjisë digjitale si pasojë e zhvillimeve të shpejta në teknologjinë digjitale.
- MASHTI të marrë në shqyrtim dhe trajtojë me seriozitet vërejtjet dhe sugjerimet e organizatave joqeveritare, njohësve e ekspertëve të fushës së edukimit medial, informacionit dhe teknologjisë informative për ta bërë prioritet këtë temë në arsimin parauniversitar. Të ketë ndërveprim dhe shkëmbime sa më të dendura mes institucioneve shkollore dhe sektorit

joqeveritar të angazhuar në edukimin medial e teknologjinë informative për të ndikuar në vetëdijesimin sa më të madh të nxënësve për efektet e edukimit medial, informacionit dhe digjitalizimit përmes formave të ndryshme, si ligjërata, simulime të ndryshme, punë praktike e në grupe etj.

- MASHTI të diversifikojë edhe më shumë partnerët aktivë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe institucionet e medias, si Komisioni i Pavarur për Media (e cila me ligjin e ri do të ketë detyrime për zhvillimin e edukimit medial), Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (e cila mund të marrë përgjegjësi shtesë për zhvillimin e edukimit medial), Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës që ta rrisë dinamikën e punës në luftimin e dezinformimit përmes aktiviteteve të edukimit medial dhe organizata të tjera të shoqërisë civile në Kosovë.

